



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/03-22143/2018
Kaçanik, 17.07.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (Shtatë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 17 Korrik 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan dy anëtarë: Kadri Krivenjeva mungoj me arsye, ndërkaq pa arsye mungoj, Vlora Dalloshi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës –Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunal; Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Fatmir Loku, Zahir Doda dhe Ramadush Osmani, ndërkaq nga zyrtarë komunal ishin: Vedat Dema, Fatlume Guri, Bejtulla Dalloshi dhe Kaltrina Luma. Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin emër për emër, ndërkaq në vazhdim e hapi mbledhjen e VII (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 17 Korrik, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017;
3. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017;
4. Propozim-Rregullore për Organizimin e punës në Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta;

5. Propozim Vendimi për fillimin e Procedurave për rishqyrtimin e Planit zhvillimor Komunal dhe harmonizimin e tij me Ligjin e planifikimit hapësinor 04/L-174;
6. Propozim Vendimi për Shfuqizim e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15509/18 për ndryshimin e destinimit të parcelës nga “Zonë ndërtimore P+2” në “Zonë ndërtimore P+5” të në parcelën kadastrale Nr. 223-1, Zona Kadastrale Bob, në emër të Fatmir Livoreka;
7. Propozim Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15507/18-për ndryshimin e destinimit të parcelës Nr. 516-1 Zona Kadastrale Kaçanik me destinim rekreative sportive, e destinuar në zonë për afarizëm dhe industriale, në pronësi të Mevlude Dushkaja.

Kryesuesi i Kuvendit, E njoftoj KK se Rendi i propozuar i punës sipas Ftesës për mbledhje, ka qenë i përbërë nga 12 pikë, mirëpo me miratimin unanimit të KPF janë hequr pikët; 6, 9-12 për shkak se këto të fundit nuk kanë qenë të kompletuara, ndërkaq pika e 6 duhet të harmonizohet me ligj. Rendi i propozuar të me këto ndryshime e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje në Procesverbal paraqitën: Ekrem Raka, të diskutimi i tij, ku thuhet se “**shumica e neneve nuk janë në rregull**” ky pasues duhet të hiqet.

z. Ekrem Kyçyku, F. 2.1 të Kërkesat, për me u futur në Kornizën Buxhetore ka qenë kërkesë e imja edhe: Zgjerimi i Lumit Neredime, dhe Ndërtimi i QMF në Kovaçec. Fusha Sportive kam thënë të ndërtohet të Parku i Qytetit, afër shkollës së mesme” Skënderbeu” në Kaçanik.

Diskutime të tjera nuk pati, kështu Procesverbali i mbledhjes së 6 të rregullt të KK me këto vërejtje u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte, Shemsedin Luzha, Abstenim nuk pati. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 6 (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 29.06.2018/ Lënda 01Nr. 60/03-19731/ 2018.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit konstaton me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Fatijona Kyçyku, Kam një Kërkesë nga banoret e lagjes “Mejdi Dalloshi” në pjesën e epërme si dhe nga banorët e pjesës së rrugës së re tek varrezat e qytetit që t’rregullohet ujësjellësi në ato pjesë dhe të mos kenë më probleme me ujin e pijes.

znj. Kaltrina Tafili, Unë iu njoftoj se nuk e kam marrë materialin e mbledhjes në asnjërin email.

z. Ekrem Kyçyku, Kam një pyetje për Kryetarin e Komunës, deri me tani i kam bërë pesë pyetje, ndërkaq nuk kam marrë asnjë përgjigje. Kjo d.m.th. se ka humbur kuptimi i parashtrimit të pyetjeve. Lidhur me pyetjet e parashtruara kërkoj të marrë përgjigje me shkrim.

z. Bekim Koxha, Unë kam një Kërkesë për Kryetarin e Komunës me na njoftuar se, a janë marrë veprime të nevojshme për rehabilitimin e rrugës afër Restorantit “Parkut”. Lidhur me këtë çështje, kemi bërë kërkesa të ndryshme, por nuk kemi marrë përgjigje.

z. Adnan Reka, A ka Komuna të planifikuar ndonjë organizim kulturor apo edukativ për mërgimtarët tanë të cilët vijnë në pushime në këtë kohë. Apo, ndoshta mjafton një mbishkrim ‘Mirë se vini mërgimtarë’ i vendosur në hyrje të qytetit, kur dihet të mirat të cilat i kanë qytetarët e komunës nga bashkatdhetarët tanë.

2. Për kundër faktit se është thënë se është bërë drenazhimi të, Varrezat e qytetit, në mënyrë që me u bërë varrimet në mënyrën si i ka hije, kjo nuk është bërë, pos një kanali i cili është hapur. Nëse nuk jam gabim, komuna ndanë nga 150€ për secilin person të vdekur, ndërkaq familjarët paguajnë sipas dëshirës shpenzimet e transportin të kufomës dhe lajmërimin e të vdekurit. Kërkesa ime për këtë çështje është; Të bëhet një Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Ekzekutivit të Komunës dhe Bashkësisë Islame me i mbuluar të gjitha shpenzimet e varrimit për qytetarët që vdesin të komunës tonë dhe të bëhet një Plan- Program i varrimeve në formë të sistemuar.

znj. Lirije Luta, Kam dy Kërkesa në emër të Lagjes “Ejup Dushkaja” në Kaçanik, për;

1. Ndriçimin publik të lagjes dhe
2. Ndërtimin e trotuarit të lagjes.

z. Shpend Krusha, Kam një Kërkesë për pajisjen e anëtarëve të Kuvendit të Komunës me Kartela Identifikuese, sepse ne anëtarët e KK kemi nevojë me i pasur kartelat, për me u prezantuar se jemi anëtarë të KK.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Kam një Kërkesë për DESHP nga banorët e Lagjes, Rakoci, për rregullimin e kalimit mbi përroin e Rakocit, sepse ashtu si është me dërrasa, është vështirë të kalohej.

znj. Hafize Sallahi, Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj” që dy ditë është pa rrymë. Me intereson të di, a janë të njoftuara organet përkatëse për këtë çështje.

Lidhur me Kërkesën e znj. Hafize Sallahi, drejtori i DAK, Zahir Doda, njoftoj se para 1 ore është rregulluar çështja e rrymës në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj”.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me problemet me emaile etj., ata të cilët kanë probleme, rregulloni ato çështje me IT, sepse unë e di së Zyra e Kuvendit ka provuar disa herë për dërgimin e materialeve të mbledhjeve qoftë edhe në formë individuale për secilin anëtar që ka kërkuar me iu dërguar përsëri. Meqë nuk pati kërkesa të tjera, atëherë konstatoj me kaluar në pikën e radhës:

2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017;

Kryesuesi i Kuvendit, Sqaroj se Raporti është sa për informacion sepse kjo çështje nuk del në votim. Besoj se Raportin e keni marrë, për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj se Raporti përmban përmbledhjen kryesore së çështjeve që dalin nga auditimit që ka bërë Zyra e Auditorit të Jashtëm. Për me bërë një vlerësim të mirë nevojitet bashkëpunim i mirë në mes të Auditorit dhe Menaxhmentit të lartë. Kjo nënkupton se çdo informacion i është ofruar nga stafi i komunës gjatë prezantimit të shënimeve, d.m.th. në asnjë rast nuk është fshehur diçka që është kërkuar t'i ofrohet auditorit. Raporti është i pamodifikuar me theksim të çështjes, ndërkaq është hera e dytë si komunë që marrim këtë opinion. Të gjeturat e auditorit janë 14, që në raport me vitin 2016 janë për 10 me pak, ndërkaq aty ku nuk jemi pajtuar është tek të HVK, shihet se janë nënvlerësuar këto të hyra, sepse auditori nuk i ka marrë parasysh të hyrat indirekte. Në vazhdim drejtori sqaroj edhe për të gjeturat të tjera sipas Raportit të auditorit një nga një, aty ku janë pajtuar apo nuk janë pajtuar si dhe zotimet e komunës për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit të auditorit, ashtu siç janë paraqitur në Planin e veprimtimit.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Me vet faktin se Raporti i Auditorit për vitin 2017 është vlerësuar i pamodifikuar me theksim të çështjes, të bënë me kuptuar se nuk jemi keq si komunë. Të çështja e pranimi teknik të QKMF, faji është i ministrisë për një nënshkrim, ndërkaq pavarësisht kësaj, kjo çështje i mbetet drejtoreshës për me gjetur personin dhe me rregulluar çështjen e nënshkrimit për pranimin teknik të objektit në fjalë. Të gjeturat janë 14 me numër, ndërkaq duhet angazhuar në të ardhmen që edhe këto të gjetura të zvogëlohen edhe më tepër.

z. Ekrem Kyçyku, Nga Raporti i Auditorit, shihet se janë evidentuar 14 të gjetura, ndërkaq edhe këto të gjetura janë shqetësim për komunën. Unë mendoj se ka pasur mundësi që gjendja të jetë edhe më mirë. Me intereson të di, a ka marrë ndokush përgjegjësi deri me tani lidhur me të gjeturat sipas Raportit të Auditorit. Të QKMF, është dashur me bërë çmos që kjo çështje me u mbyllur e mos me figuruar ende si e gjetur. Pavarësisht rritjes së buxhetit në vitin 2017 si rezultat i të HVK dhe donacioneve, shihet se vetëm 79% e buxhetit është shpenzuar për Investime Kapitale, edhe pse ka pasur projekte të parapara me buxhet për realizim. Realizimi i ulët i buxhetit për IK, ka shkaktuar ulje të performancës së komunës. Buxheti për Paga dhe Mëditje shihet se është zvogëluar si rezultat i mos plotësimit të vendeve të numrit të lejuar të punëtorëve nga, 798 të lejuara janë të plotësuar 779. Secila e gjetur paraqet parregullsi dhe mangësi, kështu shpresoj këto të gjetura të eliminohen për gjatë vitit të ardhshëm.

z. Adnan Reka, Përveç 'Theksimit të çështjes' të cilën e ka theksuar auditori, janë edhe 14 të gjetura. Disa nga të gjeturat janë me pak të arsyeshme, si; nga 8,847 prona të regjistruara, shihet se janë verifikuar 1,535. Të Pronat komunale, inkasimi është i ulët nga dhënia në shfrytëzim e tyre, pasi që nga ajo që është planifikuar, inkasohet 54% e tyre. Të punësimet me kontrata në vepër, komuna nuk ia paguan as tatimin e as kontributin, ndërkaq e ka edhe obligim ligjor me ua paguar. Një çështje që me është dukur e paarsyeshme është, ku thuhet se ; Komuna lëshon leje ndërtimi veresi. Unë kujtoj se kjo është absurde komuna me lëshuar leje ndërtimi veresi, dhe kujt ? ndërtuesve apo biznesmenëve. Pagesat për leje ndërtimi mund të behet me dy këste, por leja nuk mund të lëshohet pa u paguar të dy kështet.

z. Shpend Krusha, Të Lejet e ndërtimit, këtu është shkelje e Ligjit për Ndërtim, pasi së leja i epet palës para se më ndërtuar objektin e jo pasi të ndërton objektin. Kjo nuk është në rregull, sepse personi fizik apo juridik pasi të merr lejen mund të mos ia paguaj komunës borxhin, ndërkaq nuk ka asnjë mekanizëm me ia prishur objektin e ndërtuar, për të cilin ka leje ndërtimi.

znj. Nazife Krasniqi, Numri i të gjeturave nuk është aq i madh, në raport me vitet tjera, por nëse i analizojmë një nga një, shihet se kemi rritje të përgjegjësisë profesionale. Kur e themi këtë, p.sh, unë jam e pakënaqur në F.16, e gjetura me nr. 7.- Mos mbajtja e tatimit në burim dhe kontributeve të pensioneve. Ky gabim profesional do t'i kushtonte komunës shumë, sepse mund të gjobitet nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe tjetra mund të përballlet në Gjykatë nga punëtorët të cilët kanë punuar dhe nuk iu është paguar Trusti.

Këtë gabim profesional nga ana e Komunës e hasim çdo ditë për qëllime të ekonomisë joformale, prandaj është e sanksionuar me ligj, neni 54 ndëshkimet për mos mbajtjen e tatimit në burim -Ligji Nr. 03/L -222. Për këtë gjetje duhet të merren masa ndëshkuese në planin e veprimit dhe për gjetjet tjera që kanë të bëjnë me aspektin profesional të administratës komunale që kanë shkaktuar këto shkelje ligjore. Pos kësaj, janë edhe tre gjetje të auditorit të cilat na përcjellin që disa vite. Në F. 16, tek e gjetura me Nr. 8, në 5 dosje të testuar nuk ka asnjë Plan të menaxhimit të kontratave. Kishte qenë mirë që takimet të zhvillohen në komunë, sepse ka hapësirë për planin e menaxhimit e jo nëpër lokale e restorante. Një e gjetur tjetër është me Nr. 11 Faqe 18, trajtimi i llogarive të pa arkëtuara. Për kundër rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe zotimin e komunës për zbatimin e tij, komuna ende nuk ka marrë veprim në këtë çështje. Këtu të bënë në dyshim sikur komuna me qëllim nuk ka trajtuar llogaritë e arkëtuara. Nga lista e faljes së borxheve, del në pah se borxhlinjtë me të mëdhenj janë njerëzit e lidhur me pushtetin. Të e gjetura me Nr. 12, zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm, derisa të gjeturat e auditorit konstatojnë shkelje ligjore, e ju na sjellin këtë lloj plani të veprimit që janë si të njëjta, e që bien në dyshim si me ju konvencuar ky lloj zbatimi.

z. Ekrem Raka, Të gjeturat e listuar shihet se janë bukur serioze. Të çështja e të punësuarve në sektorin publik, mjetet të cilat kanë ngelur për mos plotësimin e vendeve të lira të punës, ku janë arsyet që nuk janë plotësuar këto vende të punës, e që si rezultat i kësaj, mjetet për Paga dhe Mëditje janë kthyer prapa.

z. Bekim Koxha, Unë po ndalem tek e gjetura të niveli i ulët i të HVK nga qiramarrja. Kjo të bënë me kuptuar se këtu nuk është diçka në rregull. Tjetër: unë nuk pajtohem se është numër i vogël i të gjeturave sipas Raportit të Auditorit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari është pajtuar me të gjeturat si në raport dhe veprimet të cilat do të merren në bashkëpunim me stafin tjetër përgjegjës për eliminimin e tyre. Janë disa të gjetura të cilat ka pasur mundësi mos me ekzistuar, si çështja e QKMF, këtu duhet të bëhet një presion me i madh të ministria për me u eliminuar kjo e gjetur. Raporti ka vend për kritika dhe lëvdata. Ekzekutivit të komunës i mbetën t'i eliminoj të gjetura dhe këto të gjetura mos të përsëritën më.

z. Bahri Selimi, Unë e potencova atë si është në raport e theksuar. Në F. 24 të Raportit, sqarohet ajo çka është e pamodifikuar. Ne si komunë e marrim për herë të dytë këtë opinion. Të gjeturat dihet se ekzistojnë dhe nuk po themi se jemi perfekt, ndërsa jemi zotuar se do t'i eliminojmë. Të planifikimi i pronave nuk është sqaruar mirë kjo në Raportin e Auditorit, sepse UA thotë që një e treta e pronave duhet të verifikohet çdo vit, ndërsa ne i kemi verifikuar 52% të pronave. Mos pagesa e kontributeve profesionale në komunën tonë, aty ku është e nevojshme komuna angazhon staf shtesë.

z. Bekim Koxha, Të investitorët nuk ka lehtësime nga komuna, sepse kompanisë "KIVO" nuk iu lehtësua me investuar në komunën tonë. Kjo të bënë me dije se komuna jonë nuk ka qenë në nivel në këtë aspekt.

Kryetari i Komunës, Ky rekomandim ka ardhur si opinion nga auditori, këto janë të gjeturat e evidentuara nga Auditori i Jashtëm dhe ne jemi pajtuar me këto të gjetura, ndërsa do të angazhohemi për eliminimin e tyre sipas Planit të veprimit të cilin e kemi propozuar. Të shpenzimi i buxhetit, sa e di unë shpenzimet e grantit janë diku mbi 96%, ndërsa tjetër është që të HVK inkasohen edhe në muajt nëntor dhe dhjetor dhe nuk mund t'i shpenzojmë në atë vit kur inkasohen. Të taksat, ne kemi qenë më liberal; duke iu dërguar shkresa për realizim, ndërsa tani është filluar përmes përmbaruesve privat me i paguar borxhet. Të punësimi, ka qenë vit fushate dhe me shpall konkurse u merrte për qëllime fushate, ndërsa sivjet unë do të marr obligim personal që t'i plotësojmë vendet e lira të punës përmes konkurseve publike. Të ri-anketimi, për çdo vit i angazhojmë zyrtarët komunal të bëjnë ri-anketim të objekteve, por nuk kemi arritur t'i përfundojmë 1/3 e tyre të përcaktuara me ligj. Të KIVO, edhe pse komuna ka shumë pak prona komunale, ne kemi ofruar atë që na takon ne si komunës në 5 lokacione (të Picrraku, në Fushë të Mulës etj.), jam munduar personalisht edhe prona të tjera private, por firmës në fjalë nuk iu kanë konvnuar lokacionet e ofruara.

z. Besim Vishi, Unë kërkoj një sqarim nga DEFZH lidhur me taksën e cila na ndalet nga "Trusti" se mos ndoshta për këtë ndalje të kësaj takse nga mëditja si anëtar i Kuvendit të Komunës po privohemi nga paga e veteranit të UÇK-së. Fjala vjen, një arsimtar merr edhe mëditjet e anëtarit të KK edhe pagën e arsimtarit, ndërsa pse neve veteraneve marrim vetëm mëditjen e anëtarit të KK, ndërsa nuk na takon edhe paga e veteranit të UÇK-së. Pyetja ishte, a ekziston mundësia që mos te na ndalet taksa për "Trust"-in në mënyrë që të na mundësohet të marrim pagën e veteranit.

Kryesuesi i Kuvendit, Sqarimet e nevojshme z. Vishi mund t'i merrni në DEFZH, ndërsa kjo është për punëtorët me Kontratë në vepër. Raporti nuk votohet, është vetëm sa për njoftim, ndërsa kalojmë në pikën vijuese;

3. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017;

Nëse ka kush diçka në këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Nga pika e mëhershme shihet se kemi pasur rënie të gjeturave, ndërkaq unë sugjeroj që ato të gjetura të cilat kanë qenë, mos të përsëriten në të ardhmen.

z. Adnan Reka, Ndonëse Plani i veprimit mund të jetë i mirë, nuk e di sa do të zbatohet, për faktin se auditori në vitin 2015 kishte dhënë 13 rekomandime, vetëm 3 janë zbatuar, në vitin 2016, nga 24 rekomandime janë zbatuar vetëm 9 prej tyre.

z. Ekrem Raka, Nëse i shikojmë përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve lidhur me të gjeturat sipas Raportit të Auditorit, shihet se në Planin e Veprimit, kryetari është shumë pak i involvuar me marrë përgjegjësi në zbatimin e të gjeturave, ndërkaq me tepër janë përgjegjës zyrtarët tjerë të komunës, si; drejtorët e drejtorive përkatëse komunale. Unë mendoj se Kryetari i Komunës duhet të zotohet për çdo rekomandim të cilin e ka dhënë auditori, në raport, për zbatimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 4 anëtarë, Abstenoj Adnan Reka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017.

4. Propozim-Rregullore për Organizimin e punës në Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta;

Kryesuesi i Kuvendit, Secila drejtori është mirë të organizoj punën e shërbimeve të tija, duke formuluar sa më tepër rregullore, sepse si komunë jemi mangët në këtë drejtim në hartimin e akteve të tilla. Për sqarime të nevojshme fjalën e ka

z. Zahir Doda, Me qëllim që të krijoj rregulla në shkollat e komunës, kështu kam hartuar draft rregulloren për shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Mund të ketë vërejtje, presim sugjerimet dhe kontributin e juaj në këtë draft. Drafti është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF, kam pasur shumë pak vërejtje. Sa për informacion kam plotësuar nenin 9 e kam shtuar edhe një pikë, me propozimin e z. Ekrem Kyçyku, sipas të cilës, drejtori shqipton masa disiplinore edhe ndaj arsimtarëve, propozim ky i cili ishte shumë i arsyeshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Edhe në mbledhjen e KPF e kemi thënë se është për t'u përshëndetur kjo rregullore për ngritjen e cilësisë në arsim. Vërejtjet e mija janë të neni 47.9 ku ndalohet mësimdhënësve të mbajë kurse në shkollë dhe objekte private me nxënësit të cilëve iu japin mësim në shkolla. Unë mendoj se me i ndalë organizimin dhe mbajtjen e kurseve private në shkolla është në rregull, ndërkaq në objekte private kujtoj se nuk është në rregull me i ndalë mbajtjen e kurseve. Kështu unë këtë pasues jam me ndryshuar, ashtu që të ndalohet

organizimi dhe mbajtja e kurseve private në shkolla. Të masat disiplinore të nxënësve të shkollave të mesme të larta, kërkoj të bëhet një normim i vërejtjeve me shkrim.

z. Adnan Reka, Ne kemi përcjell vërejtjet tona, mirëpo çështja sa janë përfillur vërejtjet tona dhe sa janë marrë parasysh. Të përgjegjësitë e drejtorit, 9.2. hartimi i planit të punës dhe planit të zhvillimit të institucionit, unë kisha thënë çdo plan duhet të jenë publike që arsimtarët dhe prindërit të dinë se çka institucioni shkollor do të punoj për gjatë një viti shkollor. Të 9.20 kisha theksuar që drejtori i njofton arsimtarët së paku 3 ditë me parë për takimet apo aktivitetet, rendin e punës etj. përpos rasteve emergjente. Këtë e themi sepse ne shpesh thirrëmi në takime aty për aty pa kurrfarë agjende. Të 9.21 e kisha futur të njoftohen mësimdhënësit 3 ditë me parë pa dallim gjinie a përkatësie për trajnime profesionale apo avancime etj. sepse disa trajnimet atraktive ka raste kur mbahen fshehtë. Tek detyrat e zëvendës drejtorit, psikologut, pedagogut, fokistit, bibliotekistit, ia kisha shtuar do të kryejnë detyrat tjera të përcaktuara nga drejtori i shkollës në pajtim me kontratën në fuqi apo me ligjin në fuqi. E kam një Rekomandim të uniforma shkollore, të neni 32 obligimet e nxënësve, të vishet në përputhje nga normat e përcaktuara nga shkolla dhe të bartë uniformën shkollore nëse ka. Këtu nuk dihet a është fjala se a ka shkolla uniforma apo nxënësi. Kjo duhet të sqarohet dhe të shënohet: Nëse është e paraparë me rregullore e shkollës përkatëse, në mënyrë që të dihet se është fjala për institucionin.

znj. Nazife Krasniqi, E përshëndes drejtorin e drejtorisë për këtë Rregullore, ndërkaq të Këshilli drejtues nuk janë përcaktuar anëtarët tjerë kush janë, sa e di unë tre anëtarë duhet të ishin nga radhët e arsimtarëve ndërkaq tre anëtarët tjerë nga kush përbëhen dhe nuk është përcaktuar mënyra funksionimit dhe detyrat.

z. Bekim Koxha, Në parim unë do të votoj Për, ndërkaq nëse drejtori i shkollës ka pasur performancë të dobët dhe përsëri është rizgjedhur drejtor në baza partiake, kjo nuk është në rregull. Ne subjekti politik NISMA, Rekomandojmë të rizgjedhin drejtorët e shkollave në bazë të meritës.

z. Nexhat Loku, Të struktura organizative në SHMU dhe SHML neni 5.5 të struktura organizative të shërbimet profesionale; pedagogu, psikologu, bibliotekisti dhe mjeku, e di se ka implikime buxhetore, por propozoj që së paku një psikolog të jetë në 4-5 shkolla, sepse punët e tyre në shkolla janë shumë të nevojshme, ndërkaq në mungesë të tyre, detyrat që iu përkasin këtij stafi profesional po duhet me i kryer arsimtarët e shkollës.

znj. Lirije Luta, E përgëzoj drejtorin për këtë draft rregullore, ndërkaq kam një Kërkesë që kjo rregullore të ketë mbikëqyrje dhe llogaridhënie të vazhdueshme në zbatimin e saj.

z. Zahir Doda, Faleminderit për propozimet, këshillat dhe komentet e juaja. Po filloj nga Kërkesa e Lirije Qelit, Rregullorja është bërë me u zbatuar. Të stafi profesional, do të kemi psikologun dhe pedagogun, e kam në prioritet nga shtatori, pasi të rregullohet çështja e mësimdhënies, aq sa më lejon ligji., por kjo nuk ka nevojë të futet në rregullore. Të pyetja e Nazifes, çështjet të cilat janë me Udhëzime Administrative si këshillat drejtuese aty janë të caktuara; përbërja, përfaqësimi dhe funksionimi etj. Keni edhe çështje të tjera të cilat jeni në dilema, por ata të cilët janë marrë me UA i dinë sesi janë të rregulluara. Nga, Adnan Reka i kam shënuar propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet dhe mund të marrë shumëçka nga to. Të uniforma është e vërtetë se është e paqartë. Të trajnimet, aktivitetet tjera, do të shtoj një pikë me Nr. 9. Të mbledhjet, e humbin efektin e tyre, nëse e shënojmë atë që u propozua sepse, ka

mbledhje që duhet të kryhen brenda ditës, kështu kisha thënë me u njoftua 1 ditë më herët. Të Planet zhvillimore të shkollës, mundemi me e futur si pikë. Të trajnimet e nxënësve nga arsimtarët, përfitimet e mësuesve nuk mund të jenë si person fizik, vetëm nëse e ka të regjistruar firmën për atë qëllim. Edhe këtu do të mundohem me korrigjuar diçka në këtë pasues.

z. Adnan Reka, Unë për çështjen e mbledhjeve të rregullta e kisha futur në rregullore që me pasur hapësirë të thirrmi më herët dhe me pasur rendin e punës. Ndërkaq për mbledhjet urgjente është diçka tjetër.

Kryesuesi i kuvendit, Nëse nuk ka kush diçka, atëherë me disa vërejte e plotësime të cilat u dhanë e që besoj se drejtori i DAK do t'i ketë parasysh, Draft- Rregulloren e propozuar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte Shemsedin Luzha, Abstenim nuk pati. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Arovimin e Rregullores për Organizimin e punës në Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta.

5. Propozim Vendimi për fillimin e Procedurave për rishqyrtimin e Planit zhvillimor Komunal dhe harmonizimin e tij me Ligjin e planifikimit hapësinor 04/L-174;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë pikë për sqarime të nevojshme fjalën e ka propozuesi, Ukshin Qallaku.

z. Ukshin Qallaku, I dha arsyet për revidimin e Planit Zhvillimor Komunal. Ai theksoj se Plani është miratuar që 7 vite dhe kemi mundësi tani me bërë ndërhyrje, pasi duhet të harmonizohet edhe me Ligjin e Planifikimit Hapësinor 04/L-174, kjo është arsyeja kryesore. Kjo iniciativë ka rrjedhur edhe si nevojë e qytetarëve të komunës, ka pasur kërkesa të qytetarëve të komunës, sepse në vitin 1980 ka ekzistuar një Vendim i cili i ka shpallur edhe tokat ndërtimore në toka bujqësore, ndërkaq në Planin Zhvillimor të cilin e kemi nuk janë përfshirë këto, ndërkaq vendimi i vitit 1980 ende nuk është shfuqizuar. Kemi raste kur shtëpia është e ndërtuar gjysma në tokë ndërtimore e gjysma tjetër në tokë bujqësore. Tani e kemi edhe autostradën e cila e ka ndryshuar komplet fizionominë e Planeve zhvillimore të komunës. Në këtë drejtim do të formohen grupet punuese të cilat do të punojnë në revidimin e PZHK, sepse kjo është e përcaktuar me ligj dhe në amën tjetër është nevojë e kohës me u bërë këto ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Shpend Krusha, Të çështja e ridenstimit të pronave bujqësore në ato ndërtimore, kujtoj se një pjesë e kompetencave i takon DBPZHR. Tokën bujqësore kujtoj se duhet të vlerëson drejtorja e Bujqësisë se a duhet t'i bëhet ndërrimi i destinimit apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit, Më herët ka qenë ashtu Shpend ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, ndërkaq tani ka ndryshuar dhe me këto ndryshime, Propozim Vendimet na vijnë nga DUKMM. Besoj se në vlerësimin e pronave, komisioni përbëhet nga dy drejtoritë.

z. Ukshin Qallaku, Unë kështu e kam gjetur gjendjen dhe kështu kam vazhduar. PZHK janë të obliguara të kyçen të gjitha drejtoritë, por me së tepërmi është në obligim të

drejtorisë për Urbanizëm. Komisioni përbëhet nga dy drejtoritë; DUKKMM dhe DBPZHR, i cili komision del në vendngjarje dhe e jep vlerësimin për pronat që kërkohet me iu ndërruar destinimi.

z. Selim Reka, Edhe në KPF jemi pajtuar me u bërë Revidimi i Planit Zhvillimor të Komunës. Lidhur me revidimet e planeve zhvillimore, unë kërkoj nga drejtoria e Urbanizmit që t'i mbledhë të gjithë profesionistët e fushave përkatëse dhe të bëhet një plan i mirë.

z. Adnan Reka, Unë vetëm do të përfitoj nga rasti t'ju përgëzoj për rifreskimin që i keni bërë ueb-faqes së vjetër të Komunës, dhe keni bërë të mundur të hapen ato dokumente që ishte e pamundur të hapeshin deri para se të kërkohej nga MAPL dhe MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) që të harmonizohet PZHK me Ligjin e Planifikimit Hapësinor

Kryesuesi i Kuvendit, PZHK është miratuar para 7-8 viteve, Është mirë që plani të hartohet mirë dhe në formë profesionale dhe në harmoni me ligjin. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë Iniciativën për ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte, Shemsedin Luzha, Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për fillimin e Procedurave për rishqyrtimin e Planit zhvillimor Komunal dhe harmonizimin e tij me Ligjin e planifikimit hapësinor 04/L-174.

6. Propozim Vendim për Shfuqizim e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15509/18 për ndryshimin e destinimit të parcelës nga “ Zonë ndërtimore P+2” në “Zonë ndërtimore P+5” të në parcelën kadastrale Nr. 223-1, Zona Kadastrale Bob, në emër të Fatmir Livoreka; dhe

7. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15507/18-për ndryshimin e destinimit të parcelës Nr. 516-1 Zona Kadastrale Kaçanik me destinim rekreative sportive, e destinuar në zonë për afarizëm dhe industriale, në pronësi të Mevlude Dushkaja.

Lidhur me këto dy pikë, Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, desha t'ia bëjë me dije drejtorit të drejtorisë se po merr vendime të njëanshme dhe të kundërligjshme, kjo është në papërgjegjësi të ekzekutivit të komunës që nuk e respekton ligjin dhe kështu po na sjellin para aktit të kryer.

z. Ukshin Qallaku, Çështja e marrjes së këtyre dy vendimeve është bërë që mos me i penguar këto dy biznese nga ndërtimet.

z. Shpend Krusha, Ne LVV kemi qenë shumë të vetëdijshëm kur këto çështja na janë adresuar në KK. Mënyra me i proceduar Propozim Vendime në Kuvendin e Komunës pa qenë të ligjshme kujtoj se nuk është në rregull. Edhe ne në KK po bimë në dilemë se a me ngritur dorën apo jo. Ne në këto raste nëse mund të themi, kemi rënë në nivelin e paditurisë, ndërkaq kujtoj se nuk mund t'i ndihmojmë popullit duke shkelur ligjin.

Kryesuesi i Kuvendit, Vendime të kësaj natyre janë marrë edhe me herët nga KK, por nuk janë kthyer nga MAPL. Unë në atë moment kur e di se një pikë nuk është në harmoni me ligjin, e heqë nga rendi i punës. Edhe Përformanca e komunës varet edhe nga ajo se sa vendime të ligjshme merr Kuvendi i Komunës.

z. Selim Reka, Në mbledhjen kur janë marrë këto vendime, ne LDK i kemi dhënë vërejtjet tona dhe për njërën kemi qenë kundër, ndërkaq për tjetrën, kemi pasur një rast me herët kur është marrë një vendim i kësaj natyre dhe kemi menduar se është në rregull.

z. Adnan Reka, Vërtet është për të ardhur keq kur ekzekutivi i komunës e bind Kuvendin të marrë vendime edhe të paligjshme dhe brenda disa muajve detyrohet t'i rishqyrtoj vendimet e veta që i ka marrë një muaj e gjysmë më herët.

z. Ekrem Raka, Shqyrtimi i këtyre dy pikave (6 dhe 7) u bë i përbashkët, ndërkaq votimi propozoj të bëhet ndaras.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin e z. Ekrem Raka e përkrahi, ndërkaq diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozimin si në pikën 6 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 3 anëtarë, Abstenim nuk pati. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shfuqizim e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15509/18 për ndryshimin e destinimit të parcelës nga “Zonë ndërtimore P+2” në “Zonë ndërtimore P+5” të në parcelën kadastrale Nr. 223-1, Zona Kadastrale Bob, në emër të Fatmir Livoreka;

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit e shtroj në votim për shfuqizimin e vendimit të përcaktuar në pikën 7 dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin Shemsedin Luzha dhe Bekim Koxha. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.350/02-15507/18-për ndryshimin e destinimit të parcelës Nr. 516-1 Zona Kadastrale Kaçanik me destinim rekreative sportive, e destinuar në zonë për afarizëm dhe industriale, në pronësi të Mevlude Dushkaja.

Për fund Kryesuesi i Kuvendit theksoj se anëtarët e KK të cilët janë në komisione, unë do të marrë veprime të nevojshme për kompensimin e mëditjeve (fjala është vetëm për kompensimin e anëtarët e KK që janë në komisione, ndërkaq pjesa tjetër nuk me takon mua), kështu që kërkoj që të dhënat lidhur me gjiro-llogarinë etj. t'i dërgojnë në DEFZH.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 12:37 e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë (25) anëtarët.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli